

## “Golden Triangle” Udhëtim në Indi

### Cmimet :

**2030** Euro per person ne dhome teke

**1790** Euro per person ne dhome dyshe/matrimoniale/treshe

### Përshkrimi i shërbimit :

Udhëtim në Indi

Dita e parë, 24 Mars: Tiranë – Delhi

Nisja nga Tirana në 12:55, udhëtojmë drejt Delhit ku do të arrijmë mëngjesin e ditës së ardhshme.

Dita e dytë, 25 Mars : Delhi

Mbërritja në aeroportin e Delhit në orën 05:00, pritja nga partnerët tanë në aeroport dhe nisja me autobus drejt qytetit Mughal AGRA. Agra është një nga qytetet më të vizituara të Indisë. Ai është i njohur për ndërtesat e periudhës Mughale ku më te përmendurat janë Taj Mahal, Keshtjella Agra dhe Fatephur Sikri, të treja të mbrojtura nga UNESCO .Akomodimi në hotel në Agra dhe ditë e lirë për të pushuar. Pasdite në kohën e perëndimit të diellit do të vizitojmë TAJ MAHAL, ndërtuar nga Perandori Shah Jahan si simbol të dashurisë në kujtim të gruas së tij Mumtaz Mahal.Kthimi në hotel dhe darka.

Dita e tretë, 26 Mars: Delhi – Fatephur Sikri – Jaipur

Herët në mëngjes do të rikthehemi në Taj Mahal për ta vizituar pallatin nën dritën e lindjes së diellit pasi kjo ndërtesë ka vecantinë që merr ngjyra të ndryshme gjatë një dite. Pas kësaj vizite do të kthehemi në hotel për mëngjesin.Konsumojmë mëngjesin dhe më tej do të vizitojmë Keshtjellen Agra. Keshtjella është ndërtuar nga Perandori i madh Akbar , shpesh përshkruhet si “Kutia e bizhuterive” ose Baby Taj.Konsiderohet si një model i Taj Mahal.

Në darkë nisja për në Jaipur “Qyteti Rozë”. Gjatë rrugës do të vizitojmë Fatephur Sikri, qyteti i ndërtuar me gurë rëre të kuqe shkretëtire nga Perandori Akbar. Më tej fshatin

Abhaneri në të cilën ndodhet pusi më i thellë dhe më i madh në Indi me rreth 3500 shkallë që zbresin në një thellësi prej 30 metrash. Gjithashtu mund të vizitojmë dhe Tempullin e Majmunëve përpara hyrjes në Jaipur.Mbërrimë në Jaipur, akomodohemi në hotel, darka dhe mbrëmje e lirë.

Dita e katërt, 27 Mars: Jaipur

E nisim ditën me një mëngjes të bollshëm dhe me energji. Sot do të vizitojmë qytetin e Jaipur duke filluar me Keshtjellen Amber, ndërtuar në shek. 16, ku mund të shijoni një shëtitje me elefant.(Opsionale kosto e përafërt 40 euro për një elefant për 2 persona).Vizitojmë Jal Mahal (Pallati i Ujit) dhe Hawa Mahal (pallati i Eres), monumentet më të rëndësishëm të Jaipur. Në drekë vizitë në Pallatin e Qytetit , një kombinim i mrekullueshëm i arkitekturës së Rajasthanit dhe Mughal. Do të ecim drejt Jantar Mantar, observatorit Astronomik. Më tej drejt Panna Meena Ka Kund & Royal Gaitor Tumba, krematoriumet e Maharaxhave.

Kohe e lirë për të pushuar ose shopping.Në mbrëmje do të vizitojmë Tempullin Birla dhe Portën Patrika, një shëtitore shumëngjyrëshe dhe një pikë ideale për të bërë foto të qytetit. Më vonë do të

Elite Travel Agency

[Rr. Kozma Naska, Nr: 33/6, 3001 Elbasan, Albania.](#)

[Rr. Faik Konica, 1000 Tirana, Albania](#)

[Telephone: +355 69 204 4656, Email: info@etg.al](#)

[www.elitetravel.al](#)

vazhdojmë drejt fshatit Choki Dhani, një nga fshatrat më tradicional të artit dhe kulturës Rajasthane. Darkë me shfaqje tradicionale. Kthim në hotel pas darkës.

Dita e pestë, 28 Mars: Jaipur – Delhi

Konsumojmë mëngjesin dhe nisemi për në Delhi. Akomodohemi në Hotel dhe do të kemi kohë të lirë. Pasdite do të vizitojmë Tempullin Grand Akshardham ku do të shijojmë dhe shfaqjen muzikore të shatërvanit.

Darka në hotel.

Dita e gjashtë 29 Mars: Delhi

Dita nis me mëngjesin në Hotel dhe do të vazhdojmë vizitën në qytetin e Delhit. Vizita fillon me Xhaminë më të madhe të qytetit Jama Masjid Jama Masjid, Chandni Chowk ku mund të shijojmë një shetitje me karrocë, dhe tregun e erëzave. Më tej do të vizitojmë Keshtjellën e Kuqe, Raj Ghat-a memorial për Mahatma Gandhi. Varrin Humayun's shembulli më i bukur i arkitekturës Mughale. Tempullin e famshëm Lotus, Minaren Qutab, Parlamentin, Pallatin e Presidentit dhe Harkun e triumfit India Gate. Pjesa tjetër e ditës do të jetë e lirë për shopping ose shetitje.

Darka në hotel.

Dita e shtatë, 30 Mars: Delhi – Tiranë

Nisja herët në mëngjes për në aeroport. Fluturimi në orën 07:00.

### **Detajet e Turit**

Ju lutem shikoni më poshtë të gjitha detajet e Turit

### **Përfshihen në çmim**

Fluturimi V/A Tirane – Delhi – Tirane

5 nete akomodim në dhoma 2-she në hotele 4\* (1 natë në Agra, 2 nete në Jaipur, 2 nete në Delhi)

Mëngjeset dhe Darkat për të gjitha ditët

Transporti me autobus komod sipas itinerarit të përshkruar në program

Guide Lokale në Anglisht Shoqerues Shqiptar nga agjensia

Biletat e hyrjeve në monumente dhe muze sipas programit

Shetitja me karroce në Chandni Chowk, Delhi

Ekskursioni në Fshatin Chokhi Dhani me darke tradicionale Rajasthane Ujë gjatë udhëtimit me autobus

Të gjitha taksat e transportit dhe hoteleve

Biletat e hyrjes nëpër monumente të përfshira në program

### **NUK përfshihen në çmim**

Drekat

Shpenzime personale

Shetitja me Elefant në Keshtjellën Amber (rreth 40 euro/elefant/2 persona) Cdo aktivitet tjetër që nuk përmendet në rubrikën "përfshihet"

Elite Travel Agency

Rr. Kozma Naska, Nr: 33/6, 3001 Elbasan, Albania.

Rr. Faik Konica, 1000 Tirana, Albania

Telephone: +355 69 204 4656, Email: [info@etg.al](mailto:info@etg.al)

[www.elitetravel.al](http://www.elitetravel.al)

Viza Indiane (29 \$ USD) Bakshishe per shoferin dhe guiden

**Shumë e rëndësishme :**

- Klienti duhet të paraqitet 3 orë përpara fluturimit në aeroport
- Pasaporta duhet të jetë e padëmtuar dhe brenda afatit të vlefshmërisë (6 muaj

**Fluturimi**

**Shqiperi – Indi 24 Mars 2024 LOT AIRLINE**

TIA 12.55 – WAW 15.00

WAW 17.05 – DEL 05.00 (dt 25 March)

**Shqiperi – Indi 30 Mars 2024**

DEL 07.00 – WAW 11.20

WAW 14.45 – TIA 16.55

**Politikat e Shërbimit**

Rezervimi me Elite Travel Agency është i sigurt dhe i thjeshtë

**PA KOSTO TË FSHEHURA**

Shikoni çdo çmim të mundshëm pa tarifa rezervimi ose kosto të tjera të fshehura.

**SIGURI NË TRANSAKSIONET TUAJA**

Ne ndjekim standardet më të larta të protokolleve të sigurisë për t’i ofruar mysafirëve tanë siguri “online”.

**POLITIKAT E PRIVATËSISË**

Ne interesohemi për privatësinë e të dhënave tuaja personale dhe marrim të gjitha masat për t’u siguruar që jemi duke ecur me hapin e kohës përpara i përket rregullave për mbrojtjen e të dhënave.

**SHËRBIMI NDAJ KLIENTIT**

Rezervimi në faqen tonë është i shpejtë dhe i thjeshtë. Nëse keni kërkesa specifike, ekipi ynë i Operacioneve do të jetë gati për t’ju asistuar.

**KONFIRMIMI I REZERVIMIT ME E-MAIL**

Menjëherë pasi të keni kryer rezervimin, një e-mail me të gjitha detajet e rezervimit do të vijë në adresën tuaj.

**PAGESA PER REZERVIMIN**

Elite Travel Agency

Rr. Kozma Naska, Nr: 33/6, 3001 Elbasan, Albania.

Rr. Faik Konica, 1000 Tirana, Albania

Telephone: +355 69 204 4656, Email: [info@etg.al](mailto:info@etg.al)

[www.elitetravel.al](http://www.elitetravel.al)

Pagesa per rezervimin do te kryhet ne dy pjese: 50% e pageses do te kryhet ne momentin e rezervimit, 50% deri ne 21 dite para nisjes

Nëse dëshironi të ndryshoni specifikat e rezervimit tuaj, mund të na kontaktoni në një nga numrat e telefonit ose me e-mail.

#### **POLITIKAT E KANCELIMEVE**

Ne rast te anulimit nga klienti aplikohen penalitetet si me poshte :

40 % nese anulimi behet deri 30 dite perpara nisjes

75 % nese anulimi behet 30 deri ne 15 dite perpara nisjes 100% nese anulimi behet 14 dite perpara nisjes

Nese klienti qe kerkon te anulloje udhetimin e zevendeson rezervimin e tij me nje person tjeter, atehere politikat e anulimeve do te diksutohen sipas rastit konkret.

Anullimi do të quhet se është kryer në momentin që klienti paraqitet personalisht (ose i përfaqësuar nga një pjestar i grupit kur udhëtimi është rezervuar në grup) në njërën nga zyrat e agjencisë ose duke dërguar e-mail në adresën [info@etg.al](mailto:info@etg.al) për t'u tërhequr nga marrëdhënia e krijuar me agjencinë.